



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PUSTEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.1328/1 Prot

Pustec, më 10.09.2025

PROCESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK

1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar dhe akteve nënligjore që rregullojnë procesin e përfshirjes së publikut në vendimmarrje, në datën 10.09.2025 u zhvillua një **takim konsultativ publik** me banorët e Bashisë Pustec. Takimi kishte për qëllim: **Mbledhja e rekomandimeve për prioritetet e komunitetit për draftin e dytë të projekt buxhetin afatmesëm 2026 – 2028**

Propozuesi: Projekt aktet janë propozuar nga Ekzekutivi/Kryetari i Bashkisë, Z. Pali Kolefski

Sqarime për projekt aktin: *Nevojat e komunitetit për përmirësimin e shërbimeve publike bazuar në buxhetin 2026-2028*, informimin e qytetarëve mbi projektet e planifikuara dhe mbledhjen e komenteve, pyetjeve dhe propozimeve të tyre për zhvillimin e zonës.

Banorët patën mundësi të konsultojnë draftin e dytë të PBA 2026-2028 në lidhje me çështjet për diskutim, në linkun e mëposhtëm:

<https://files.fm/u/gnujvz4k7f>

2. PJESËMARRËSIT

Në takim morën pjesë:

- Kryetari i Bashkisë Pustec
- Përfaqësues të administratës bashkiake
- Këshilltarë të Këshillit Bashkiak
- Banorë të fshatrave të Bashkuisë Pustec
- Përfaqësues të grupeve të interesit

Lista e plotë e pjesëmarrësve me emër, mbiemër, funksion dhe nënshkrim do të bashkëngjitet këtij procesverballi si aneks.

3. HAPJA E TAKIMIT

Takimi u hap nga Kryetari i Bashkisë, i cili:

- përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe uroi mirëseardhjen;
- theksoi rëndësinë e konsultimeve publike për të përfshirë komunitetin në planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
- sqaroi se qëllimi i këtij takimi është **prezantimi i projekteve të planifikuara dhe mbledhja e komenteve nga qytetarët** për të reflektuar më mirë nevojat e komunitetit.

4. ÇËSHTJET E PARASHTRUARA NGA KRYETARI

Kryetari bëri një paraqitje të detajuar të projekteve dhe nismave që janë planifikuar ose janë në proces, duke përfshirë:

1. **Shtrimi i rrjetit të energjisë elektrike** në të gjithë territorin e bashkisë me kablllo cilësore dhe të certifikuar, për të siguruar furnizim të qëndrueshëm dhe të sigurt për familjet dhe bizneset.
2. **Investim në rrjetin e kanalizimeve deri në vitin 2026**, me financim nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, për përmirësimin e kushteve higjiëno-sanitare dhe mbrojtjen e mjedisit.
3. **Nisja e projektimit urban për rrugën Lajthizë–Zaroshkë**, me qëllim përmirësimin e aksesit, sigurisë dhe zhvillimit të turizmit në zonë.
4. **Propozimi për ndërtimin e një shëtitoreje përgjatë vijës liqenore**, për të krijuar një hapësirë publike rekreative që do të nxisë turizmin dhe aktivitetet ekonomike.
5. **Rikonstruktion i ish-zyrave të kooperativës dhe përshtatja e tyre si qendra multifunksionale**, ku parashikohet të zhvillohen aktivitete kulturore, edukative dhe sociale për komunitetin.
6. **Aplikime pranë ambasadave të huaja për financim projektesh**, me fokus në infrastrukturë, mjedis dhe shërbime komunitare.
7. **Fillimi i ndërtimit të rrugës së poshtme në fshatin Kallamas (2.5 km)** brenda muajit shtator, që do të përmirësojë lëvizjen dhe lidhjen brenda fshatit.
8. **Sistemim dhe asfaltim i rrugëve të fshatit Pustec**, sidomos rrugëve dytësore që aktualisht janë në gjendje të amortizuara.
9. **Riparimi i 14 shtëpive për familjet e varfra dhe të pafavorizuara**, me qëllim përmirësimin e kushteve të banimit dhe rritjen e cilësisë së jetesës.
10. **Dranazhimi dhe pastrimi i rezervuarëve**, për të rritur kapacitetin ujëmbajtës dhe shmangur përmytjet.
11. **Mbjellja e pemëve në hapësira publike** për rritjen e sipërfaqeve të gjelbra dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit.
12. **Vendosja e ndriçuesve publikë në fshatra** për rritjen e sigurisë gjatë natës.

5. PYETJE, SUGJERIME DHE PROPOZIME NGA PËRFAQËSUESIT DHE BANORËT

Pas paraqitjes së kryetarit, të pranishmit ngritën pyetje dhe bënë propozime si më poshtë:

- Kërkesë për **sigurimin e transportit të përditshëm për nxënësit e gjimnazit nga fshatrat e tjera** drejt shkollës në Pustec.
- Nevoja për **rregullimin dhe pajisjen me infrastrukturë të fushës sportive në Pustec.**
- Pyetje nëse **janë ndërruar të gjitha shtyllat elektrike në fshatin Goricë e Madhe** dhe nevoja për inspektim të rrjetit.
- Kërkesë për **mbushjen me dhe të anëve të përroit të ndërtuar në Goricë e Madhe** për të shmangur shembjet dhe dëmtimet nga reshjet.
- Propozim për **ndërtimin e një ure që lidh fshatin Goricë e Madhe me tokat bujqësore**, për të lehtësuar qasjen dhe punimin e tyre nga banorët.
- Shqetësim për **hedhjen e mbeturinave në hyrje të Goricës së Madhe**, që shkakton ndotje dhe erë të keqe, dhe kërkesë për vendosjen e një kontejneri të mbyllur ose ndalimin e hedhjes në atë zonë.
- Pyetje nëse **ka një vendgrumbullim të posaçëm për hedhjen e inerteve në Goricë e Madhe** dhe propozim për caktimin e një vendi të veçantë për këtë qëllim.
- Kërkesë për **gjetjen e një mënyre alternative për trajtimin e mbetjeve dhe ndalimin e djegies së tyre në Pustec.**
- Propozim për **pastrimin e përroit të Pustecit**, për të shmangur përmytjet dhe dëmtimin e pronave gjatë stinës së shirave.
- Kërkesë për **vendosjen e llampave ndriçuese në varrezat e Pustecit dhe vendosjen e një dere në hyrje të tyre** për të rritur sigurinë dhe mirëmbajtjen.
- Sugjerim për **gjetjen e një lokacioni tjetër për grumbullimin e inerteve në Goricë e Madhe**, pasi aktualisht vendi është pranë përroit.
- Kërkesë për **krijimin e një këndi çlodhës për pensionistët në fshatin Lajthizë**, me stola dhe hapësirë të gjelbër.
- Kërkesë për **pastrimin e kanalit anës rrugës në Lajthizë**, për të përmirësuar kullimin dhe shmangur dëmtimin e rrugës.
- Sugjerim për **ndërtimin e një kambanareje për komunitetin.**

Të gjitha pyetjet dhe propozimet u morën në konsideratë dhe u regjistruan për ndjekje nga strukturat përkatëse të Bashkisë.

6. MBYLLJA E TAKIMIT

Kryetari falënderoi të gjithë pjesëmarrësit për kontributin, pjesëmarrjen dhe interesimin e treguar dhe garantoj se të gjitha komentet dhe propozimet do të shqyrtohen dhe, nëse janë të realizueshme, do të përfshihen në planin e zhvillimit dhe investimet e ardhshme të Bashkisë Pustec.

Takimi u mbyll në orën 1:30 , në një atmosferë bashkëpunuese dhe konstruktive.



Lista e pjesëmarrësve bashkëngjitur procesverbalit (emër, mbiemër, funksion, nënshkrim)

Procesverbali u përgatit nga:

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Todora TËRPO